

KËRKESE PËR OFERTA

Projekti ToKeQark SB NI KOS 09/2023

Termet e Referencës

Korrik 2023

Afati i hapur për aplikim: 5 gusht 2023

Fillimi i konsulencës: 20 gusht 2023

Mbarimi i konsulencës: 30 nëntor 2023

Për The Balkan Forum

The Balkan Forum (BF) është një platformë rajonale shumësektoriale që punon për të shtyrë përpara dialogun ndër-kufitar dhe për të krijuar një vizion dhe agjendë të përbashkët rajonale për veprim bashkëpunues në rajonin e Ballkanit bazuar në integrim ekonomik, prosperitet dhe paqe të qëndrueshme. Theksin e kemi tek praktikat e mira të bashkëpunimit rajonal, diskutimet e politikave dhe promovimi i përpjekjeve ekzistuese për të lidhur iniciativat, njohuritë dhe sukseset me nivelet vendimmarrëse që janë përgjegjëse për politikëbërjen dhe integrimin rajonal dhe/ose në BE. Së bashku me partnerët tanë ne fokusojmë përpjekjet tona në plotësimin e mangësive dhe mobilizimin e veprimeve; lehtësimin e ndërtimit të konsensusit dhe dialogut; dhe të vullnetit politik për veprim mbi iniciativat e bashkëpunimit rajonal. Plani Strategjik 2021 – 2025 i The Balkan Forum angazhohet të punojë drejt ndërtimit të kapitalit njerëzor, forcimit të një ekonomie qarkore dhe reduktimit të papunësisë dhe emigracionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Projekti “ToKeQark”

Projekti “ToKeQark” SB NI KOS 09/2023 ka si qëllim parësor promovimin e qëndrueshmërsisë mjedisore dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike duke i trajtuar sfidat mjedisore përmes përfshirjes së komunitetit/palëve në diskutim, si dhe të ofrojë informata të përditësuara lidhur me tranzicionin drejt ekonomisë qarkore në Kosovë e në veçanti, në katër komuna të Kosovës: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Mitrovicë. Projekti financohet nga SMART BALKANS, i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) dhe zbatohet nga The Balkan Forum.

1. Hyrje

The Balkan Forum kërkon të rekrutojë një konsulent/ ekip konsulentësh, që të zhvillojnë një hulumtim në kuadër të projektit “ToKeQark” mbi zgjidhjet ekzistuese dhe potencialet inovative/teknologjike në Kosovë, rajon dhe BE për sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike, mjedisin dhe rekomandimet për përshpejtimin e tranzicionit të Kosovës drejt ekonomisë qarkore.

2. Konteksti

150 vitet e fundit të industrializimit janë karakterizuar nga një model ekonomik linear i bazuar në parimin "merr-bëj/prodho-hidh". Ky model ka nxitur rritjen e varësisë nga burimet e shtershme/pakta, duke rezultuar në degradim mjedisor dhe në sasi skandaloze mbetjesh. Për të luftuar këto dukuri dhe pasojat e tyre të gjera, është bërë domosdoshmëri zhvillimi i një ekonomie qarkore, bazuar në parimin e përdorimit të reduktuar të burimeve. Duke iu përkushtuar këtij parimi, ekonomia qarkore synon të minimizojë përdorimin e burimeve, emetimet e karbonit dhe gjenerimin e mbetjeve. Kjo rezulton në krijimin e sistemeve të mbyllura përmes ripërdorimit të vazhdueshëm, rindarjes, riparimit, rinovimit, riprodhimit dhe riciklimit. Dëshmitë sugjerojnë se kalimi nga një ekonomi lineare në një ekonomi qarkore është një sfidë e madhe që kërkon angazhim më të fortë për menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve dhe burimeve.

Kosova përballet me një sfidë të madhe në tranzicionin drejt ekonomisë qarkore. Krahasuar me homologët e vet evropianë, vendi mbetet prapa në ndërmarrjen e hapave të duhur drejt këtij qëllimi. Aktualisht, Kosova përballet me disa pengesa që pengojnë ndërgjegjësimin dhe motivimin e qytetarëve për t'u përfshirë në një ekonomi qarkore. Këto përfshijnë mungesën e infrastrukturës dhe stimujve ekonomikë, si dhe edukimin e kufizuar mbi ndryshimet klimatike, mjedisin dhe parimet e një ekonomie qarkore.

Situata aktuale mjedisore përbën një kërcënim jo vetëm për mjedisin, por edhe për jetën dhe shëndetin e

njerëzve, si dhe për ekonominë. Mund të ketë edhe pasoja të theksuara në ndryshimet sociale që lidhen me rreziqet e sigurisë.

3. Objektivat e Konsulentit / Hulumtuesit

Përcakton dhe zbaton saktësisht objektivat, qëllimin dhe metodologjinë që do të përdoret, për të kuptuar dhe hartuar raportin përfundimtar mbi sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike, mjedisin dhe hapat e nevojshëm për tranzicion në ekonomi qarkore në Kosovë.

4. Roli i Konsulentit / Hulumtuesit – Rezultatet e pritshme

Hulumtimi mbi inovacionin dhe hartëzimi

Zhvillimi i një hulumtimi mbi zgjidhjet ekzistuese dhe potencialet inovative/teknologjike në Kosovë, rajon dhe BE për sfidat që lidhen me ndryshimin e klimës, mjedisin dhe ekonominë qarkore. Hulumtimi do të informojë zhvillimin e kornizës për mbledhjen e statistikave të matshme që do të përdoren në të ardhmen nga partnerët dhe palët e tjera të interesit, por edhe përmbajtjen e trajnimeve (Aktiviteti 2), dhe mbështetjen e iniciativave rinore (Aktiviteti 3) në kuadër të projektit.

Më konkretisht konsulenti/ja do të jetë përgjegjës/e për detyrat në vijim:

1.1 Metodologjia e Hulumtimit

- përcakton saktësisht objektivat, qëllimin, metodologjinë që do të përdoret, palët e interesit që do të përfshihen, si dhe rezultatet përfundimtare. Temat që do të trajtohen: sfidat klimatike dhe mjedisore, ndërlikohet e ndryshimeve klimatike me paqen dhe sigurinë në Kosovë, zgjidhjet inovative të ekonomisë qarkore për ndryshimet klimatike dhe sfidat mjedisore që mund të përdoren në nivel lokal, programet arsimore (institucionet e arsimit të lartë) për ndryshimet klimatike, mjedisin dhe ekonominë qarkore.

1.2 Mbledhja dhe analiza e të dhënave

- Në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe OJQ-të, dhe me përfshirjen e të rinjve nga 4 komunat, grupet multidisiplinare prej 3 personash në secilën prej 4 komunave (Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Mitrovicë) zhvillojnë kërkime/hulumtime, me udhëzime dhe mbështetje nga Balkan Forum (BF)/LogEx.
- Rishikimi i literaturës dhe raporteve ekzistuese.
- Mbledhja e të dhënave parësore përmes intervistave individuale dhe diskutimeve në fokus grupe me palët relevante të interesit në 4 komunat dhe në nivelin qendror të Kosovës.
- Analiza e të dhënave përmes trekëndëshit (*triangulation*) të informacionit të mbledhur, krahasimi i të dhënave në 4 komuna.

1.3 Hartimi i Raportit Hulumtues

- Do të përgatitet një raport prej rreth 20 faqesh, i cili do të prezantojë metodologjinë e përdorur, palët e interesit të përfshira dhe natyrisht gjetjet kryesore nga hulumtimi. Raporti do të jetë i disponueshëm në shqip, anglisht dhe serbisht, në mënyrë që të jetë i qasshëm për një audiencë të gjerë.

The Balkan Forum mbulon koston e lektorimit, përkthimit dhe dizajnit të raportit/hulumtimit final

1.4 Përkthimi dhe dizajni i Raportit/Hulumtimit

- Raporti do të shkruhet në shqip dhe do të lektorohet dhe përkthehet në serbisht dhe anglisht.
- Raporti do të ketë një dizajn tërheqës dhe modern për lexuesin.

5. Periudha e konsulencës / Hulumtimit

Hulumtimi pritet të zbatohet në periudhen gusht – nëntor 2023.

6. Buxheti I alokuar për realizim të aktivitetit 3.1 Hulumtimi mbi inovacionin dhe hartëzimi

Kategoria	Buxheti bruto [EUR]
Hulumtues/e me përvojë	1,750.00

7. Përvoja

Të interesuarit duhet të demonstrojnë se kanë përvojë / njohuri:

- Mbi 5 vite përvojë në zhvillim të hulumtimve/kërkimeve studimore, apo rasteve studimore.

- Të demonstrojnë me 1-2 shembuj përvojën / rolin e tyre në hulumtime.
- Njohuri dhe përvojë në realizim të hulumtimeve kërkimore në fusha apo tema si p.sh., mjedisi, ekonomia qarkore, ndryshimet klimatike, politikat lokale etj., do të kenë përparësi në vlerësim.
- Përvoja e tyre në ekonomi qarkore konsiderohet përparësi thelbësore.
- Aftësi të mira të komunikimit.
- Aftësi të forta ndërpersonale, ndjeshmëri dhe vëmendje ndaj detajeve.
- Aftësi për të ofruar punë me cilësi të lartë, brenda kornizës kohore të rënë dakord.

8. Të intersuarit duhet të dorëzojnë

- Ofertën që specifikon metodologjinë e hulumtimit, planin dhe periudhën e realizimit.
- CV për përvojën.
- Të paktën një shembull të hulumtimit/ analizës të ndërmarrë nga konsulentit/ja

Procedura e aplikimit

Oferta dërgohet në email adresën gazmend@thebalkanforum.org. Aplikimet që nuk përbajnë dokumentet e kërkuara në Pikën 8 nuk do të konsiderohen për vlerësim.

Afati për aplikim është i hapur deri me datë 5 gusht 2023.

Vetem kandidatet që hyn në listë të ngushtë do të kontaktohen nga ekipi i The Balkan Forum